



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës	
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm, MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Donika Gërvalla - Schwarz , Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë Ridvan Hoti , Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë	
Nga:	Lulzim Beqiri , Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Drejtësisë	Datë: 26.06.2026
Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Rinor Gjergji - U.D. Udhëheqës i Divizionit për Legjislacionin e Fushës Penale dhe për Organizimin e Sistemit të Drejtësisë/ Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësië	
Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Valmira Uka , Zyrtare e Lartë Ligjore, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Pejës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar i Komunës, i nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal

Ministria e Drejtësisë, në pajtim me nenin 9 dhe nenin 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, bazuar në Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe në përputhje me Rregulloren (QRK) - Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, me datë 04.06.2026 ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, aktin e komunës në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 34/2026 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e servitutes reale për instalimin e kablllos nëntokësore, ZK Sfërkë në Pronësi të Komunës së Pejës.
I miratuar më datë: 29.05.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.06.2026
I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Drejtësisë më datë: 04.06.2026

Ministria e Drejtësisë, pas analizimit dhe shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridik.

ARSYETIM

Ministria e Drejtësisë ka shqyrtuar Vendimin e Kuvendit të Komunës së Pejës Nr. 34/2026 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e servitutit real për instalimin e kablllos nëntokësore në ZK Sfërkë, në pronësi të Komunës së Pejës.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit është analizuar baza ligjore materiale mbi të cilën është mbështetur akti, si dhe pajtueshmëria e tij me legjislacionin në fuqi.

Nga përmbajtja e vendimit konstatohet se Kuvendi i Komunës së Pejës ka vendosur për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e një servituti real në një pronë të paluajtshme në pronësi të komunës, për qëllim të instalimit të kablllos nëntokësore. Kjo çështje lidhet me administrimin dhe ushtrimin e të drejtave pronësore mbi pronën publike komunale dhe hyn në kompetencat e organeve komunale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Drejtësisë vlerëson se akti është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Neni 15 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike përcakton se njësitë e vetëqeverisjes lokale ushtrojnë të drejtat pronësore mbi pronën publike komunale në pajtim me ligjin, ndërsa neni 253 paragrafi 1 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore parasheh se servituti real mund të themelohet me veprim juridik, me vendim të organit shtetëror ose me ligj. Për rrjedhojë, themelimi i servitutit real mbi pronën komunale paraqet një veprim juridik të lejuar nga legjislacioni material në fuqi.

Ministria e Drejtësisë, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.